

+



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA KORÇË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**DREJTORIA E STREHIMIT SOCIAL DHE MENAXHIMIT TË BANESAVE SOCIALE**

**Datë, \_\_. \_\_. 2023**

**RELACION**

**PËR**

**NJË KORRIGJIM TË TABELËS BASHKANGJITUR NË VENDIMIN NR.114**

**DATË 31.08.2023**

**“ MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA ”**

Në mbështetje të Ligjit nr.22/2018, “Për Strehimin Social”, të neneve 3, 16, 33, 34 dhe 38 të këtij ligji, “VKM 384, datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, në VKM 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij” VKM nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, VKB nr. 183 datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2023 të Bashkisë Korçë”, është miratuar V.K.B. nr.10, datë 25.01.2023 “ Mbi miratimin e subvencionit të qirasë për familjet e pastreha “, me listën emërore të aplikantëve për përfitimin nga programi i Subvencionit të Qirasë. Subvencioni i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira,që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale në tregun e lirë.Masa e subvencionit përlllogaritet në varësi të të ardhurave të familjes. Ky program i dedikohet kryesisht familjeve me pak ose pa të ardhura.

Nga verifikimi i të dhënave në tabelën bashkangjitur vendimit nr.114 datë 31.08.2023, u konstatua një gabim në lidhje me llogaritjen e shumës që mbulohet nga buxheti i Bashkisë që si rrjedhim ndryshon dhe shumën që mbulohet nga buxheti i Shtetit në muaj për aplikantin përfitues të Bonusit të Qirasë me numër rendor 4(katër) në tabelë Fjonika Shkodrani:

Shuma mujore që mbështetet nga buxheti i Bashkisë për Fjonika Shkodrani ishte 5,000 lekë në muaj dhe nga përlllogaritja bëhet 4,500 lekë.

Shuma mujore për Bashkinë Korçë në total për 4 përfituesit ishte 12,873 lekë, bëhet 12,373.5lekë.

Shuma mujore që mbështetet nga Buxheti i Shtetit për Fjonika Shkodrani ishte 10,000 lekë, bëhet 10,500 lekë.

Shuma mujore për Buxhetin e Shtetit në total ishte 28,372 lekë, bëhet 28,871.4 lekë.

Shuma vjetore nuk ndryshon dhe do të jetë për periudhën nga 01.09.2023 deri 31.12.2023

Këto ndryshime pasqyrohen në tabelën nr.1, që si rrjedhojë ndryshojnë vetëm shumën mujore të subvencionit të qirasë për këto 4 familje..

Për arsyet e përmendura me lart, Drejtoria e Strehimit i paraqet Këshillit Bashkiak relacionin për korrigjimin e tabelës bashkëngjitur V.K.B. nr.114, datë 31.08.2023 “ Mbi miratimin e Subvencionit të Qirasë për familjet e pastreha “.Trajtimi nga ky program për këto familje do të jetë për 4 muaj,për periudhën 1 Shtator 2023 deri më 31 Dhjetor 2023.  
Bashkëngjitur tabela nr.1, me 4 familjet përfituese për vitin 2023.

**M. Balli**  
Drejtore e Strehimit  
Social dhe Menaxhimit  
të Banesave Sociale .

**V. Ziko**  
Drejtore e Përgjithshme e  
Buxhetit dhe MFK.

**A.( Dishnica) Qeramixhi**  
Drejtore e Përgjithshme Juridike  
dhe e Burimeve Njerëzore

**KRYETARI I BASHKISË**  
**Sotiraq Filo**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2023

**PËR  
NJË KORRIGJIM TË TABELËS BASHKANGJITUR VENDIMIT NR. 114  
DATË 31.08.2023  
“ MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E  
PASTREHA ”**

Në mbështetje të Ligjit nr.22/2018, “Për Strehimin Social”, të neneve, 3, 16, 33, 34 dhe 38 të këtij ligji, “VKM 384, datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, në VKM 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij” VKM nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, VKB nr.183, datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2023 të Bashkisë Korçë”, është miratuar VKB. Nr.10 datë 25.01.2023 “Miratimin e subvencionit të qirasë për familjet e pastreha” me listën emërore të aplikantëve për përfitimin nga programet sociale të strehimit.

Propozohet për miratim korrigjimi në listën emërore të familjes përfituese me nr. rendor 4(katër) Fjonika Shkodrani, për përfitimin nga programi i Subvencionit të Qirasë (Bonusi i Strehimit). Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi analizoi dhe shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale,

**VENDOSI:**

- 1.Të miratojë korrigjimin në tabelën bashkangjitur vendimit nr. 114, datë 31.12.2023 “ Mbi miratimin e subvencionimit të qirasë për familjet e pastreha “,sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Subvencionimi i Qirasë për këto 4 familje do të jepet nga data 1 Shtator 2023 deri më datën 31 Dhjetor 2023.
- 3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe MFK.
- 4.Ky vendim hyn në fuqi dhjetë ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
**Eva NAÇI**

**KRYETAR**  
**Ana VERUSHI**

Miratuar me \_\_\_\_\_ vota  
Vota Pro \_\_\_\_\_  
Vota Kundër \_\_\_\_\_  
Vota Abstenim \_\_\_\_\_  
Zbardhur më datë \_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

**VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2023

**MBI KORRIGJIMIN E TABELËS BASHKANGJITUR VENDIMIT NR.114  
DATË 31.08.2023 PËR” SUBVENCIONIMIN TË QIRASË PËR FAMILJET E  
PASTREHA”**

Në mbështetje të Ligjit nr.22/2018, “Për Strehimin Social”, të neneve, 3, 16, 33, 34 dhe 38 të këtij ligji, “VKM 384, datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, në VKM 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij” VKM nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, VKB nr.183, datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2023 të Bashkisë Korçë”, është miratuar V.K.B. nr 10.

Propozohet për miratim korrigjimin në listën emërore të familjes përfituese me nr. rendor 4(katër) Fjonika Shkodrani, për përfitimin nga programi i Subvencionit të Qirasë (Bonusi i Strehimit).

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi analizoi dhe shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë korrigjimin në listën bashkangjitur vendimit nr. 114, datë 31.08.2023 “ Mbi miratimin e subvencionimit të qirasë për familjet e pastreha “,sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Subvencionimi i Qirasë për këto 4 familje do të jepet nga data 1 Shtator 2023 deri më datën 31 Dhjetor 2023.
- 3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe MFK.
- 4.Ky vendim hyn në fuqi dhjetë ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

**Eva NAÇI**

**KRYETAR  
Ana VERUSHI**

Miratuar me \_\_\_\_\_vota

Vota Pro\_\_\_\_\_

Vota Kundër\_\_\_\_\_

Vota Abstenim\_\_\_\_\_

Zbardhur më datë\_\_\_\_\_

